



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:115975
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05500741

AA.nr.697/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar i kolegjit, Hajriz Hoti dhe Mehmet Ndrecaj anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditëses V.H, Komuna e Podujevës, kundër të paditurës Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, A.nr.982/2023 të datës 17.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses V.H, Komuna e Podujevës, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.982/2023 i datës 17.08.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative A.nr.982/2023 të datës 17.08.2023, është refuzuar kërkesa e datës 09.08.2023, me të cilën paditësja V.H, Komuna e Podujevës ka kërkuar nga gjykata, lirimim nga pagimi i taksës gjyqësore në lëndën A.nr. 982/23.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësja, për shkak të: vërtetimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit të shfuqizoj aktvendimin e Gjykatës themelore në Prishtinë dhe të më liroj nga pagesa e taksës gjyqësore ngase vërtet për mua është e pa përbalueshme dhe e dëmshme për mua dhe familjen time.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar

Paditësja me datën 09.08.2023, i ka parashtruar gjykatës kërkesë për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, për shkak se është në gjendje të vështirë ekonomike dhe nuk ka mundësi të paguaj taksën gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar kërkesën e paditëses, iu referua nenit 7.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/2, i cili përcakton se “personi mund të lirohet nga pagimi i taksës gjyqësore, vetëm atëherë kur vërtetohet se ai ose ajo, siguron dëshmi se është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ose e Agjencisë pasardhëse, ose nëse personi siguron dëshmi se, ai ose ajo është duke marrë ndihmë ligjore nga Zyra e Qarkut për Ndihmë Ligjore”. Paditësja kërkesës së parashtruar ja ka bashkangjitur kartelën e ndihmës sociale, mirëpo e njëjta nuk është valide për arsye se i ka skaduar vlefshmëria me datë.28.02.2023 dhe si rezultat i ndërprerjes së ndihmës sociale me vendimit nr. 0743 të datës.15.03.2023 e njëjta ka parashtruar padi në gjykatë.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, e po ashtu nuk është i përfshirë as me vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Këtë vlerësim gjykata e shkallës së dytë e mori për shkak se me provat që gjenden në shkresat e lëndës bindshëm dhe në mënyrë të sigurt, është vërtetuar fakti vendimtar se paditësi nuk ka dëshmuar me asnjë provë se i plotëson ndonjërin nga kriteret e përcaktuara me nenin 8 të Udhëzimit të lartcekur.

Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, vlerësimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë, kjo për faktin se me dispozitën e nenit 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 të datës 22.03.2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, përcaktohet se “8.1 Lirohen nga pagesa e taksës kategoritë e personave si në vijim: 8.1.1 personi i cili parashtron kërkesën që ka të bëjë me marrëdhënien e punës, përveç kërkesave në të holla; 8.1.2 personi me gjendje të vështirë ekonomike, nëse pagesa e taksës ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ekzistencës së tij, respektivisht të anëtareve të familjes së tij apo të personave tjerë të cilët varen nga ai; 8.1.3 Familjet e dashnorëve të UÇK-së, dhe të zhdukurve në luftë; 8.1.4 Invalidët e UÇK -së; dhe 8.1.5 Familjet e viktimave civile të luftës”. Ndërsa me nenin 8.3 të Udhëzimit të lartcekur është përcaktuar se “8.3 Kategoritë e personave nga neni 8.1, për tu liruar nga taksat duhet të sigurojnë këto prova 8.3.1 dëshmi se ai/ajo është përfitues i ndihmës sociale

nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale 8.3.2 dëshmi se ai/ajo është duke marrë ndihmë ligjore nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas 8.3.3 dëshmi mbi statusin e familjareve të dëshmorëve të UÇK-së dhe të zhdukurve 8.3.4 dëshmi mbi statusin e Invalidit të UÇK-së 8.3.5 dëshmi mbi statusin e familjarëve të viktimave civile të luftës. Prandaj, në rastin konkret nga kërkesa e parashtruar nga paditësja dhe nga pretendimet ankimore të paditëses se nuk ka të ardhura që të paguaj taksat, nuk është dëshmuar me asnjë provë.

Me nenin 253.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se “Paditësi ka për detyrë që padisë t’ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar”. Ndërsa me nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se “Secila palë parapakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”. Kurse me nenin 12.11 të Udhëzimit të lartcekur, është përcaktuar se “Për padi kundër aktit administrativ, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, kur vlera e kontestit është e pamatshme, është 50 €”

Andaj, pretendimet ankimore të paditëses, se i njëjta duhet të lirohet nga pagesa e taksës gjyqësore për padi, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike kërkojmë të lirohem nga pagesa e taksës gjyqësore ngase konsiderojmë e kemi bazën ligjore të cilën na e garanton Ligji i Procedurës Kontestimore i cili është më i lartë se një udhëzim administrativ, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, sepse këto pretendime ankimore i vlerëson si të pa bazuara për tu aprovuar ankesa. Ngase, nga shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja nuk ka dëshmuar me asnjë provë se e njëjta i plotëson kushtet për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, sipas dispozitave ligjore të lartcekura.

Prandaj, duke u bazuar në këto dispozita ligjore, kolegji i kësaj gjykate vlerëson së Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë ka refuzuar kërkesën e paditëses për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr.697/2023, me datë 06.03.2024

Kryetari i kolegjit
Ramiz Kuqi